



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

---

# Strategjia Afatgjatë e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile 2015 - 2020

-1-

*Përgatitur nga  
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile*

Prill 2017



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

**TREGUESI I LËNDËS:**

**KAPITULLI I**

**Vështrim i Përgjithshëm**

1.1. Hyrje.....	Faqe 3
1.2. Struktura dhe Përmbajtja e Strategjisë.....	Faqe 3

**KAPITULLI II**

**Vizioni, Objektivat dhe Drejtimi i Strategjisë 2015 - 2020**

2.1. Vizioni dhe Politikat.....	Faqe 3
2.2. Parime Bazë të Mbështetjes së Shoqërisë Civile.....	Faqe 4
2.3. Objektivat Cilësorë.....	Faqe 4
2.3. Objektivat Strukturorë.....	Faqe 5

**KAPITULLI III**

Masat Strategjike.....	Faqe 5
------------------------	--------

**KAPITULLI IV**

Korniza e Monitorimit.....	Faqe 6
----------------------------	--------

**KAPITULLI V**

**Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile**

5.1. Themelimi.....	Faqe 6
5.2. Historiku.....	Faqe 7
5.3. Hyrja në Fuqi.....	Faqe 8

**ANEKS**

Grupi i Ekspertëve.....	Faqe 9
-------------------------	--------



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

## **KAPITULLI I**

### **Vështrim i Përgjithshëm**

#### **1.1. Hyrje**

Strategjia Kombëtare e Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) 2015 - 2020 është një dokument i rëndësishëm për zhvillimin e Shoqërisë Civile në Republikën e Shqipërisë- si sektor i rëndësishëm në zhvillimin tërësor të vendit.

Strategjia Kombëtare e AMShC- së duhej përgatitur në kuadrin e strategjive sektoriale për periudhën vijuese pas vitit 2015, sipas udhëzimeve të Qeverisë.

Por, gjithashtu, kjo strategji përfaqëson dhe pasqyron nismat, politikat dhe objektivat e reja të Qeverisë dhe nënvizon rëndësinë e Shoqërisë Civile si sektori kryesor për ndërmarrjen e nismave të reja në të mirë dhe interes të publikut.

Kjo strategji pasqyron programin e Qeverisë për reformat në gjithë sektorët, me synimin për ta vendosur shoqërinë civile në drejtimit e zhvillimit të qëndrueshëm

Gjithashtu, kjo strategji pasqyron kërkesën e gjithë palëve të interesuara për pritshmëri të larta lidhur me kontributet e AMShC- së dhe nevojën për rolin drejtues e përgjegjës paralel me bashkëpunimin me Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.

#### **1.2. Struktura dhe Përmbajtja e Strategjisë**

Dokumenti i strategjisë për AMShC-në, konsiston e ndarë në tre pjesë:

1. Pjesa analitike si dokument mbështetës;
2. Dokumenti bazë i strategjisë me objektivat dhe
3. Masat dhe plani i veprimit;

## **KAPITULLI II**

### **Vizioni, Objektivat dhe Drejtimi i Strategjisë 2015 - 2020**

#### **2.1. Vizioni dhe Politikat**

Që prej themelimit të saj në vitin 2009, AMShC-ja ka bërë përpjekje të mëdha si në investime të kapaciteve menaxhuese, procedurave për financim, rregulloreve, procedurave të monitorimit, të raportimit financiar dhe për sa i përket aktiviteteve në kuadër të projekteve të financuara etj. Gjatë viteve të para, AMShC ka përdorur fondet në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit qeveritar. Pjesa më e madhe e këtyre përpjekjeve kanë qenë burokratike dhe operationale. Si një agjenci e re me një staf relativisht të vogël, ky proces ka qenë i lavdërueshëm. Në këtë moment nevojitet të



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

përmirësohen procedurat për shpërndarjen e fondeve publike e veçanërisht për grantet institucionale.

Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020 si dhe Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërisë Civile dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Udhërrëfyesit ka filluar përgatitjen dhe zbatimin për një plan të ri strategjik për të drejtuar/rritur përpjekjet e saj për të transformuar veten në:

- Një motor në zhvillimin kombëtar të Shqipërisë dhe integrimin në Bashkimin Europian;
- Në një donator të standardeve europiane, të barabartë me agjencitë e tjera të ngjashme të Evropës dhe transparent në proceset grantdhënëse;
- Në një donator në gjendje të financojë jo vetëm grante, por të sigurojë asistencë teknike për shoqërinë civile të një cilësie të lartë, të kryejë analiza, duke qenë një ndikim i plotë në vendimmarrje dhe politikëbërje;

## **2.2. Parime Bazë të Mbështetjes së Shoqërisë Civile**

Strategjia e Agjencisë për 2015 - 2020 njih dhe vlerëson përpjekjet e jashtëzakonshme të Bordit Mbikqyrrës si dhe stafit të AMSHC-së, drejtuar nga Drejtori Ekzekutiv i saj, si në investimet e nevojshme për të rritur kapacitete menaxhuese, ashtu edhe për të bërë funksionimin operacional të AMShC- së. Janë instaluar tashmë procedurat dhe rregulloret për financim dhe të gjithë mekanizmat e tjerë për grant dhënie. Në tërësinë e saj, strategjia e AMShC- së mbështetet në parimet e mëposhtme:

1. Parimin e Transparencës përgjatë tërë realizimit të procesit të grantdhënies;
2. Parimin e Efekshmërisë së procesit të vendimmarrjes së organeve publike;
3. Parimin e përgjegjësisë së organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore ndaj palëve të interesuara;

## **2.3. Objektivat Cilësorë**

Strategjia e re përcakton objektiva cilësorë strategjike për të cilat AMShC do të jetë përgjegjëse për arritjen e tyre. Të ndara, këto objektiva do të ishin si më poshtë të paraqitura:

- Organizimi i suksesshëm me qëllim performance të lartë në procesin implementues të Institucionit;
- Identifikimi i AMShC- së si Institucion transparent në vendimmarrje dhe shpërndarje jo të përqëndruar financiare;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

- Fuqizimi i administratës së AMShC- së me efikasitet dhe kapacitete teknike- lider të shoqërisë- civile;
- Raportimi mbi impaktin e projekteve të financuara nga AMShC në interes dhe të mirë të publikut dhe target- grupeve të caktuara;

#### **2.4. Objektivat Strukturore**

Në vazhden e këtyre iniciativave, AMShC- së, i është kërkuar të zgjerohet strukturalisht dhe funksionalisht. Për nga ana e strukturës, AMShC- së i është shtuar një njësi e veçantë me varësi direkte nga Drejtori Ekzekutiv i saj duke kryer funksionin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Vlen të theksohet se kjo strukturë, do të zgjerohet edhe më tej duke patur parasysh, integrimin dhe përfaqësimin në nivel ndërkombëtar si partneritet por edhe bashkëpunues me Institucione Ndërkombëtare.

Në tërësi, këto synime janë të dizajnuara për të konsoliduar procedurat dhe masat e marra për funksionimin e AMShC- së si dhe për të hedhur bazat për përmirësime të mëtejshme për të ardhmen e saj.

### **KAPITULLI III**

#### **Masat Strategjike**

Strategjia e tërë procesit financues të AMShC- së, inicohet përmes shpalljes publike të iniciativës së ndërmarrë nga ku, thirren të gjithë subjektet përfituese por edhe target- grupet për pjesëmarrje dhe dhënie të konkluzioneve përkatëse.

Ndodhur në këtë situatë, stafi i AMShC- së, mban shënimet përkatëse në formë përmbledhëse dhe pas realizimit të takimit, çdo mendim, kërkesë, sugjerim apo informacion, mbahet shënim për një fazë të dytë të procesit e cila ka të bëjë me formësimin e prioriteteve finale.

Më tej, stafi i AMShC-së, integron sugjerimet në planin financues. Subjektet pjesëmarrëse në takimin konsultativ, duke qenë se i njohin edhe më nga pranë problematikat sociale dhe shoqërore, angazhohen seriozisht në nxjerrjen e konkluzioneve mbi atë se çfarë në të vërtetë nevojitet për një zonë të caktuar. Propozimet duhet të jenë të natyrave të ndryshme, duke nisur nga lloji i financimit e deri te proceset lehtësuese të politikave fiskale të qeverisë.

Me realizimin në tërësi të këtyre takimeve, stafi i AMShC- së, përgatit një procesverbal përmbledhës të të gjitha sugjerimeve të ndara përkatësisht me pika orientuese për çdo lloj strategjie e cila synohet të implementohet. Në fund të këtij procesi, komisioni përgjegjës, shpall në faqen e tij zyrtare të gjithë informacionin e mbledhur, problematikën e shfaqur por edhe



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

mënyrën e zgjidhjes së saj dhe normalisht, këto sugjerime, i përcillen Bordit Mbikqyrës të AMShC- së si organi më i lartë vendimmarrës në Institucion.

## **KAPITULLI IV**

### **Korniza e Monitorimit**

AMShC-ja, duke përbërë mekanizmin qëndror për financimin publik të programeve të OShC-ve në Shqipëri, ka përpara sfidida dhe punë në funksion të përmirësimit të saj, e sidomos për ripërcaktimin e rolit dhe punës që të jetë më proaktive dhe sa më afër OSHC-ve në nivel vendor dhe lokal gjithashtu. Për të siguruar monitorim sa më efektiv të AMShC- së dhe harmonizimin e prioriteteve për financim si me planet strategjike kombëtare ashtu edhe me nevojat e OSHC-ve, AMShC- ja do të marrë pjesë aktive në punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe të dorëzojë raportet vjetore të financimit publik të OShC- ve pranë Këshillit Kombëtar për diskutim dhe vlerësim. Bordi mbikëqyrës do të kontrollojë zbatimin e planit strategjik, Drejtori Ekzekutiv i është përgjegjës për zbatimin e saj. AMShC është një agjenci unike në Europë në atë që është një agjenci publike e pavarur shqiptare, e krijuar me ligj të posaçëm; Ligji Nr. 10093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut.

## **KAPITULLI V**

### **Këshilli Kombëtar Për Shoqërinë Civile**

#### **5.1. Themelimi**

Referuar nevojave dhe synimit për përafrimin e legjislacionit por jo vetëm, edhe strukturave shtetërore për funksionim edhe më të saktë të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ndërmoi iniciativën për themelimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Misioni themelor i këtij Këshilli do të jetë garantimi i bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile në dobi dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.

Në vazhden e kësaj nisme, qeveria shqiptare, në fundvitin e 2015-ës, miratoi Ligjin Nr. 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

AMSHC-ja luan rolin e sekretariatit teknik të KKShC-së dhe lehtëson, nga ana logjistike, mbajtjen e takimeve. AMShC-ja kryen vetëm funksione ndihmëse dhe administrative për KKShC-në; organizimin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të OSHC-ve në Këshill, pas një ftese publike dhe duke respektuar parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes

## **5.2. Historiku**

Tiranë, 13 shkurt 2015, në ambjentet e AMShC-së u zhvillua një takim pune me Zyrën e BE-së, Tiranë. Qëllimi i takimit ishte forcimi i bashkëpunimit AMSHC-BE, njohja me opinionet dhe mendimet e përfaqësuesve më të rëndësishëm të shoqërisë civile në Shqipëri dhe pasqyrimi i tyre në opinionin që do të përgatisë Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian.

Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të misionit të Këshillit Social dhe Ekonomik Evropian që ishin z. Ionut Sibian, Kryetar i Komisionit për Ndjekjen e Çështjeve të Ballkanit Perëndimor, z. Christoph Lechner (Group II- Punëtorët), z. Cveto Stantič (Group I-Punëdhënësit), z. Cédric Cabanne, REX Sekretariat, përfaqësuesi i delegacionit të BE-së në Tiranë për shoqërinë civile, z. Stefano Calabretta, Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së, z. Andi Kananaj dhe disa anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës, konkretisht znj. Kozara Kati, z. Aldo Merkoci dhe z. Ismail Ademi.

Tiranë, 17 mars 2015, nis procesi i konsultimit të Draftit final për projektligjin për "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile", në sallën e madhe të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR). Ky proces konsultimi udhëhiqet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim të ngushtë me AMSHC-në dhe Grupin Teknik të Punës.

Takimet e ardhshme konsultative nëpër rrethe u zhvilluan në qytetin e Shkodrës, Gjirokastrës dhe Korçës.

Në muajin Prill 2015, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) përmbyllën me sukses, procesin e takimeve rajonale me organizata dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile lidhur me konsultimin e gjerë të Projektligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile". Në këto takime morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), AMShC-ja, grupi teknik i punës si dhe përfaqësues nga organizatat dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

### **5.3. Hyrja në fuqi**

Më 16 nëntor 2015 hyn në fuqi Ligji KKSHC (119/2015). Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) fillon procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile në zbatim të Ligjit Nr. 119 datë 06.11.2015 "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" (KKSHC). Për të siguruar një procedurë transparente dhe të hapur të zgjedhjeve të përfaqësuesve të OSHCsë në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, AMSHC-ja paraqet dhe hapat kryesorë që duhet të ndërmerren.

Tiranë, 4 shkurt 2016, në ambientet e Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) u zhvillua takimi përmblyllës i konsultimeve në lidhje me procedurën për zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile si anëtarë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC). Ky takim u organizua nga MMSR-ja në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC). Në këtë takim morën pjesë Ministri i MMSR-së, z. Blendi Klosi, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, z. Andi Kananaj, përfaqësuesi i Zyrës së Delegacionit të Bashkimit Evropian, z. Stefano Calabretta, anëtarja e Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së znj. Kozara Kati si dhe një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC).

Tiranë, 2 mars 2016, nëpërmjet një Deklarate për Shtyp, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në vijim të konsultimeve dhe rekomandimeve të ekspertëve vendas dhe të huaj, njofton për periudhën e dorëzimit të nominimeve si edhe për organizimin e disa takimeve me qëllim informimin sa më të gjerë të shoqërisë civile mbi rëndësinë dhe procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) në qytetin e Shkodrës, Pogradecit, Vlorës, Kukësit dhe Korçës. Në datën 26 prill 2016, Hapet procesi i votimit online për kandidatët e KKSHC-së, i cili zgjati deri më datë 4 maj 2016.

Tiranë, 13 qershor 2016, pas një procesi të verifikimit dhe rikonfirmimit të votuesve AMSHC shpall listën emërore me anëtarët e zgjedhur nga organizatat e shoqërisë civile për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).

Tiranë, 23 qershor 2016, në ambientet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) u mbajt takimi i parë i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Në këtë takim morën pjesë Kryetari i KKSHC-së, z. Blendi KLOSI dhe anëtarët të tjerë të KKSHC-së. Të pranishëm ishin gjithashtu znj. Majlinda DHUKA, zv/Kryetare e BM të AMSHC-së; znj. Kozara KATI, anëtare e Bordit Mbikëqyrës të AMSHC-së; Z. Stefano CALABRETTA, përfaqësues i Delegacionit të BE-së si dhe përfaqësues të tjerë nga shoqëria civile. Nga përfaqësuesit e pranishëm u hodhën ide dhe propozime të





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

---

ndryshme, pas të cilave u zgjodhën me konsensus tre anëtarë nga KKSHC për të qenë grup i punës. Ky grup u ngarkua të merrej me hartimin e Rregullores së KKSHC-së.

Tiranë, 15 shkurt 2017, Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) zhvilloi një mbledhje pranë mjediseve të Kryeministrisë, e cila u drejtua nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klosi në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Në mbledhje u ftuan të merrnin pjesë edhe organizata të shoqërisë civile dhe media. Në datën 1 mars 2017, pranë zyrave të AMSHC-së, u zhvillua hedhja e shortit për caktimin e kohëzgjatjes së mandatit e anëtarëve.

## **ANEKS**

### **Grupi i Ekspertëve**

1. Znj. Desareta LAMEBORSHI - Përgjegjëse e Sektorit
2. Z. Kastriot TOTA - Specialist
3. Znj. Ermela BEKTIC - Specialiste
4. Z. Ferhat AGA - Mbikqyrës